



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

**A nr. 347/ 2010**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga, Muhamet Rexha kryesues, Ferit Osmani dhe Rafet Haxhaj, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike Kosovës (PDK) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) me seli në Prishtinë, për shkak të pengimit të mbajtjes së tubimit parazgjedhore me elektoratin, në seancën e panelit të mbajtur me 12.12.2010, mori këtë:

## **V E N D I M**

**REUZOHET** ankesa si e pabazuar e subjektit politik, Partia Demokratike e Kosovës (PDK).

## **A r s y e t i m**

Më 6 Dhjetor 2010, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga subjekti politik PDK me të cilën pretendohet se në tubimin parazgjedhor me elektorat të paralajmëruar më 06.12.2010, në shkollën fillore “Zenel Hajdini” në Prishtinë, është penguar nga grupet të organizuara simpatizantësh nga subjekti politik LDK, të cilët kanë provokuar, djegur flamurin e subjektit politik PDK dhe kanë hedhur gurë në drejtim të zyrtarëve të lartë të PDK-së. Sipas parashtruesit të ankesës kjo është një shkelje e rëndë e procesit zgjedhor dhe do të ndikoj negativisht në mbarëvajtjen e zgjedhjeve të lira dhe demokratike. Me propozim që të ndërmerren masat e parapara ligjore. Parashtruesi i ankesës nuk i ka bashkangjitur asnjë provë ankesës.

PZAP-i e informoi subjektin politik LDK më datë 08.12.2010, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet në ankesë deri më datë 09.12.2010, gjerë në orën 12:00. PZAP-i mori përgjigje në ankesë nga subjekti politik LDK, sipas afatit të caktuar. Në përgjigje të subjektit politik LDK, theksohet se ankesa në fjalë është pabazuar për shkak se parashtruesi i ankesës nuk ka bashkangjitur asnjë provë ku dëshmohet se simpatizantët e subjektit politik LDK, kanë qenë të implikuar në këtë çështje. Me propozim, që ankesa të refuzohet si e pabazuar.

**Neni 118 paragrafi 1 dhe 4 të LZP-së, parashohin:**

*118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet.*

*118.4 Mund të apelohej vendimi i PZAP-it, sikurse që PZAP-i mund të rishikojë cilindo nga vendimet e marra, pas prezantimit të fakteve të reja nga pala e interesuar.*

PZAP duke u bazuar në dispozitën e nenit 118.1 të LZP-së, rezervon të drejtën për të rishqyrtuar këtë ankesë kurdo që Policia e Kosovës dhe pala e interesuar do të sjell fakte të reja lidhur më rastin konkret.

PZAP-i, pasi që kërkoj nga policia tri herë radhazi informata për rastin konkret dhe pasi që shqyrtoi dhe analizoi të gjitha shkresat e lëndës gjeti se:

**- ankesa është e pabazuar.**

Pretendimet nga parashtruesi i ankesës, se janë bërë shkeljet e theksuara në ankesë nga simpatizantët e subjektit politik LDK janë të pabazuara për shkak se nuk janë ofruar dëshmi të mjaftueshme për të besuar se kanë ndodhur shkeljet e lartpërmendura. Ky fakt konfirmohet edhe prej raportit të Policisë me nr. AN-3/10 të datës 08.12.2010 në të cilin theksohet se nuk ka pasur hedhje gurësh apo dhunë, nuk janë sulmuar automjetet zyrtare, po ashtu në këtë raport thuhet se nuk është vërtetuar se këta persona kanë qenë simpatizant të subjektit politik të LDK-se. Në raportin shtesë të Policisë së Kosovës me nr. AN-3/10 të datës 11.12.2010 theksohet se: *“është identifikuar dyshimi i mundshëm por nuk është intervistuar, pasi i njëjti gjendet në arrati. Nuk mundemi të konstatojmë se i dyshuari i përket ndonjë subjekti politik apo jo, për derisa ai të mos intervistohet”*. PZAP-i duke u bazuar në arsyet e cekura më lartë, në pajtim më dispozitat e cituara ligjore dhe gjithashtu në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitivin e këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

A nr. 347/2010 më datën 12.12.2010.

**Kryesuesi i Panelit  
Muhamet Rexha**

